



REPUBLIKAE KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
Komuna Junik - Opština Junik			
01/Nr.Port.	Nje. Cip.	Nr.Ifaq	Jata
24/751	2	6	01.02.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY JUNIK

---

**RREGULLORE PER RREGULLIMIN E PËRDORIMIT TË  
PIJEVE ALKOOLIKE NË LOKALET PUBLIKE**

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 3 të Statutit të Komunës së Junikut, nen 12.2 shkronja (c) e Ligjit Nr.03/ L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e mbajtur më: ----- miratoi këtë:

(Draft): RREGULLORE

**PER RREGULLIMIN E PËRDORIMIT TË PIJEVE ALKOOLIKE NË  
LOKALET PUBLIKE**

**Neni 1**

**Akronimet dhe Definicionet**

**DEZH** - Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit;

**PK** - Policia e Kosovës;

**GJKK** - Gjykata Komunale për Kundërvajtje;

**LEJE** - Nënkupton lejen për shitjen dhe përdorimin e pijeve Alkoolike;

**Pije Alkoolike** –Nënkupton pijet me përbajtje te alkoolit si rakia, verërat, birrat etj;

**Lokal Afarist** - Nënkupton objektin apo hapësirën punuese ku ushtrohet veprimtaria;

**Person Juridik** - Nënkupton Shoqërinë aksionare, Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, Ndërmarrjen Publike, Organizatën dhe Asociacionin tjetër të Regjistruar në Regjistrin e Bizneseve;

**Person Fizik** - Nënkupton individin ose personin Fizik si pronar i ndërmarrjes së regjistruar si biznes Individual;

**Autoritet Gjegjës** - Nënkupton organet e autorizuara për mbikëqyrjen ne baze te kësaj rregulloreje si dhe dispozitave te veçanta qe rregullojnë këtë lëmi.

## Neni 2.

### Dispozitat e përgjithshme

Me këtë rregullore përcaktohet organi kompetent për dhënien e Lejes për shërbimin me pije alkoolike, lejimin dhe përdorimin e pijeve alkoolike në lokalet afariste, si dhe procedurat dhe kushtet për dhënien e Lejes.

## Neni 3.

**3.1** Të gjitha lokalet afariste publike të cilat në veprimtarinë e tyre e kanë edhe shërbimin me pije alkoolike, në baze të kësaj Rregulloreje janë të obliguara të kenë Lejen për përdorimin e pijeve alkoolike në ato lokale.

**3.2** Leja për përdorimin e pijeve alkoolike jepet nga organi kompetent komunal në baza vjetore.

## Neni 4

### Kushtet dhe mënyra e dhënies së Lejes

**4.1** Sipas kësaj Rregulloreje organ kompetent për dhënien e Lejes për përdorimin e pijeve alkoolike në Lokalet Afariste është Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit.

**4.2** Në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës për pajisje me Leje, organi i cekur në paragrafin **4.1**, është i obliguar që parashtruesit të kërkesës t'ia lëshoj Lejen përkatëse për shërbimin dhe përdorimin e pijeve alkoolike, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

## Neni 5.

Për dhënien e Lejes për pije alkoolike lokalet afariste duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të parashtrojnë kërkesë për pajisje me leje për lejimin e përdorimit të pijeve alkoolike;
2. Të ketë të regjistruar biznesin përkatës;
3. Të paguajnë taksen komunale dhe atë:
  - a) në lartësi prej 20 € për dhënien e lejes për shitjen dhe përdorimin e pijeve alkoolike për motele dhe hotele dhe,
  - b) në lartësi prej 10 € për dhënien e lejes për shitjen dhe përdorimin e pijeve alkoolike për kafeteri, bare, restorante, qebaptore, dhe lokalet tjera në të cilat lejohet konsumimi i alkoolit.

## Neni 6.

Lejen për shërbimin dhe përdorimin e pijeve alkoolike mund ta kërkojnë: hotelet, motelet, kafeteritë, baret, restorantet, qebaptoret, dhe lokalet e ngjashme të kësaj natyre.

## Neni 7

Nuk lejohet përdorimi dhe shërbimi me pije alkoolike në byrektore,ëmbëltore, kioske dhe lokale tjera të cilat nuk janë te regjistruala për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

## Neni 8

**8.1** Reptësisht ndalohet shërbimi i të miturve me pije alkoolike.

**8.2** Obligohen të gjitha lokalet afariste të cilave iu është dhënë leja për shërbimin dhe përdorimin e pijeve alkoolike që në vendin e dukshëm të vendosin mbishkrimin me këtë përmnjatje: “**ndalohet shërbimi me pije alkoolike i të miturve**”.

## Neni 9.

Gjatë organizimit të manifestimeve të ndryshme në vende të hapura, subjektit afariste janë të obliguar që t'iu përbahen të gjitha dispozitave të përcaktuara në këtë rregullore për shërbimin me pije alkoolike sikurse në lokale të mbyllura.

## Neni 10.

### Marrja e Lejes

**10.1** Lokali i cili posedon lejen përkatëse për përdorimin dhe konsumimin e alkoolit, në të cilin në mënyrë të vazhdueshme prishet rendi dhe qetësia publike, dhe kjo paraqitet si pengesë për objektet përreth, gjegjësisht i cili dështon në mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike gjatë orarit të punës, ose lejon aktivitete të palejueshme do t'i merret Leja për përdorimin e pijeve alkoolike për atë vit kalendarik.

**10.2** Kërkesën për marrjen e Lejes për shkaqe të cekura më lartë mund të parashtronë: PK –ja dhe Inspektorët përkatës Komunal.

## Neni 11.

Vendimin për marrjen e Lejes në bazë të kërkesës së organit nga paragrafi **10.2**, e merr organi kompetent i cili e ka dhënë Lejen për përdorimin e pijeve alkoolike sipas kësaj Rregulloreje.

## Neni 12.

### Masat ndëshkuese dhe gjobat

12.1 Organet e inspektoratit komunal janë të obliguara që të mbikëqyrin zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe të ndërmarrin masa adekuate në pajtim me këtë Rregullore.

12.2 PK-ja (Policia e Kosovës) është e autorizuar dhe mund të mbikëqyrë respektimin e dispozitave të kësaj rregulloreje, dhe për këtë ta njoftojë inspektoratin komunal për çdo parregullsi të hasur dhe të kërkojë ndërmarrjen e masave adekuate.

12.3 Lidhur me aktivitetin nga paragrafi 1 i këtij nenit, mund të ndërmerrin masat dhe veprimet përkatëse sanksionuese nga dënimini mandator, iniciimi i procedurës kundërvajtëse, dhe shqiptimi i masave tjera ndëshkuese, gjobave e gjerë te marrja e Lejes së punës ose Lejes së përdorimit të pijeve alkoolike.

## Neni 13.

13.1 Dëndimi mandator në lartësi prej 50 €, do t'i shqiptohet pronarit të subjektit afarist për mos përbajte të dispozitave nga nenet 8 dhe 9, të kësaj Rregulloreje, ne rast te refuzimit te pagesës ngritët procedura kundërvajtëse dhe lartësia e dënitit është 70 deri në 100 €.

13.2 Me gjobë prej 100 € deri në 200 €, do të dënöhët për kundërvajtje Subjekti afarist i cili nuk disponon Leje për përdorimin e alkoolit konform dispozitës së nenit 6 dhe 7 të kësaj Rregulloreje.

## Neni 14

14.1 Pagesa e të gjitha dënimive mandatore behet me rastin e shqiptimit të dënitit, ne te kundërtën ngritët procedurë për kundërvajtje nga inspektori komunal.

14.2 Në rast se pronari i subjektit afarist nuk bënë pagesën e dënimive në afatin e përcaktuar në paragrafin 14.1, ndaj tij do të iniciohet procedura kundërvajtëse, pranë Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Deçan.

## Neni 15

Të gjithë subjektet afariste të cilat në lokalet e tyre shërbehen me pije alkoolike , janë të obliguara që në afat prej 30 ditëve, nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje të parashtrojnë kërkesë për tu pajisur me Leje përkatëse.

### **Neni 16**

Mjetet e arkëtuara nga shqiptimi dënimive përkatëse në kuptim të dispozitave paragrafët **13.1, 13.2** do të derdhën në Buxhetin Komunal.

### **Neni 17**

Në implementimin e kësaj Rregullore përveç organeve kompetente Komunale, do të angazhohen dhe organet e tjera kompetente, Policia e Kosovës dhe organi gjyqësor për kundërvajtje.

### **Neni 18**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të sajë nga Kuvendi i Komunës së Junikut.

Datë: 30.01.2012  
Junik

